

VENDIM
Nr.986, datë 1.12.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31.12.2010, për procedurat e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2010, sipas listave nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA NR.1

PROKURIME TË MIRATUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.782, DATË 29.9.2010, PËR TË CILAT NUK KA PËRFUNDUAR PROCEDURA E PROKURIMIT

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit me TVSH (lekë)
1	Rikonstrukcion QKU, ESKU, Tiranë reparti ushtarak nr.4400	31 000 000
2	Ndërtim rrjeti elektrik në repartin ushtarak nr.1320 Tiranë	9 700 000
3	Blerje aksesore shtesë të komandimit në distancë (për misionin Afganistan)	9 062 515
4	Blerje karburanti JET-A1	53 881 776
5	Blerje protoxid azoti	565 900
6	Blerje kite laborator	3 691 990
7	Blerje medikamentesh mjekësore	24 011 520
8	Blerje dezinfektantësh	2 000 000
9	Blerje materiale mjekimi	10 022 560
10	Materiale për funk. e pajisjeve speciale	3 181 140
11	Materiale, shërbime speciale, mrëmbajtje, scaner etj.	3 019 990

LISTA NR.2

(PROKURIMET E PAMIRATUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.782, DATË 29.9.2010)

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit me TVSH (lekë)
1	Blerje dekoratash të ndryshme	10 510 000

2	Blerje dhe montim çelësash elektrikë	2 200 000
3	Shërbim transporti për materiale logjistike	2 700 000
4	Blerje uniformash	50 000 000